



Pranuar / Dorezuar Prenjenshi/Prudatu Received/Delivety	30.08	2023	3	viti god year
Organ /Hjesht Organ /Jedinita Org./Unit	No Prot No Prot Prot No	Shtojca Prllog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTICK	5899	/2023	115	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.998/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.998/2023, të datës 17.07.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Komuna e Hanit të Elezit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafët 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 30.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.998/2023 e datës 17.07.2023 e parashtruar nga ankuesi ashtu që aprovohet si i bazuar pretendimi ankimor lidhur me mos shqyrtimin dhe mos aprovimin e kërkesave të ankuesit për pjesëmarrje në takime dhe tryeza zyrtare, **ndërsa përfundon procedimi administrativ** lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për mos aprovim të pjesëmarrjes në trajnime.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, (*tutje vetëm ankuesi*), më datë 17.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.998/2023, për shkak të mos miratimit të kërkesave për takime zyrtare dhe trajnime, nga mbikëqyrësja e tij e drejtpërdrejt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, më

datë 21.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Hanit të Elezit, ndërsa, kjo e fundit, me datë 27.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesaveka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5258/2023 të datës 17.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin të datës 25.11.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin të datës 27.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin të datës 16.01.2023; Ftesën për trajnim me Nr.06-323 të datës 04.04.2023 nga MAPL; Agjendën e datës 13.04.2023; Komunikimin elektronik të datës 21.04.2023, 05.04.2023, 07.04.2023 ndërmjet udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankuesit, ankuesit dhe personave gjegjës të Komunës së Hanit të Elezit; Ftesën për trajnim të datës 15.05.2023 nga OSCE; Rendin e ditës për datën 08-09.06 2023 lidhur me agjendën për ngjarjen Rritja e komunikimit me media dhe marrëdhëniet me publikun dhe trajnime për menaxhimin e mediave sociale; Komunikimin elektronik përmes e-mailit zyrtar te datës 30.05.2023, 18.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe udhëheqëses së tij të drejtpërdrejtë; Ftesën për trajnim të datës 02.06.2023 nga MAPL se bashku me agjendën e bashkangjitur; Komunikimin elektronik të datës 08.06.2023 ndërmjet ankuesit, udhëheqëses së tij të drejtpërdrejtë si dhe personave gjegjës të institucionit; Ftesën dhe agjendën e datës 23.06.2023 lidhur me punëtorinë dy ditore me kolegjiun për komunikim me publikun nga Asociacioni i Komunave të Kosovës; Komunikimin elektronik te datës 26.06.2023, 23.06.2023 ndërmjet ankuesit, udhëheqëses së tij të drejtpërdrejtë; Procesverbalin e bordit të drejtorëve me numër 02/Nr.5153 të datës 23.06.2023; Procesverbalin e bordit të drejtorëve me numër 02/Nr.5280 të datës 30.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 27.07.2023 nga Komuna e Hanit të Elezit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankuesit të datës 30.12.2011 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës te datës 15.11.2011; Planin vjetor të trajnimit për nëpunësit civil me numër 02Nr:1154/2023 të datës të datës 31.01.2023; Komunikimet elektronike të datës 21.06.2023, 22.06.2023, 23.06.2023, 13.02.2023, ndërmjet ankuesit, udhëheqëses së tij të drejtpërdrejtë dhe personave gjegjës të institucionit në fjalë; Përgjigjen me Nr.Prot.03/6210 të datës 27.07.2023 nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit në lidhje me objektin e ankesës së ankuesit; Njoftimin me numër 05/6039 2023 nga Drejtoria për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport në Komunën e Hanit të Elezit; Postimet dhe publikimet në facebook lidhur me aktivitetet e zhvilluara në Komunën e Hanit të Elezit; Komunikimin elektronik të datës 17.05.2023, 13.02.2023, 13.02.2023, 17.05.2023, 07.04.2023, 12.04.2022, 25.10.2022, 05.05.2022, 26.05.2022, 12.07.2022, 12.08.2022 dhe 06.12.2022 ndërmjet ankuesit dhe udhëheqëses së drejtpërdrejtë të tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është pjesërisht e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Hanit të Elezit dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 30.12.201, është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Arkivit dhe Transparencës* në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi gjatë periudhës janar-qershor 2023, ka pranuar disa ftesa për pjesëmarrje në trajnime dhe takime zyrtare të organizuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, OSBE dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, e për të cilat

ankuesi kishte njoftuar Drejtoreshën për Administratë të Përgjithshme në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt dhe njëkohësisht kishte kërkuar nga e njëjta miratimin për pjesëmarrje në takime apo trajnime, përkatësisht ankuesi me datë 05.04.2023 kishte pranuar festë nga MAPL-ja për pjesëmarrje në tryezën me temën “ Prezantimi i Raportit mbi vlerësimin e transparencës komunale” me ç ‘rast ankuesi kishte përcjell kërkesën për miratim të pjesëmarrjes te Drejtoresha për Administratë të Përgjithshme, e cila me datë 12.04.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit për pjesëmarrje në tryezën në fjalë. Po ashtu, ankuesi me datë 18.05.2023 kishte përcjell kërkesën për aprovim të pjesëmarrjes në trajnimin e organizuar nga OSCE me temën “ Rritja e komunikimit me media dhe marrëdhëniet me publikun dhe menaxhimin e mediave, 8-9 qershor”, me datë 08.06.2023 ka dërguar kërkesën për aprovim të pjesëmarrjes në tryezën e organizuar nga MAPL-ja me temën “ Sfidat nga Plani i veprimit për Transparencë dhe Rregullorja për transparencë komunale, datë 16.06.2023” , me datë 23.06.2023, ankuesi përcjell kërkesën për pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, për anëtarët e Kolegjiumit për Komunikim më Publikun, 26 qershor 2023, e për të cilat kërkesa ankuesi nuk kishte marrë asnjë përgjigje- gjegjësisht konfirmim qoftë për aprovim apo për refuzim.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos aprovimin e ndjekjes së takimeve dhe trajnimeve, pretendon që mos aprovimi i trajnimeve është shkelje ligjore dhe është bërë diskriminim për shkak se trajnimet janë të nevojshme sepse edhe pozita që mban është e nevojshme të ketë trajnime.

Kolegji i Këshillit në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore, ju referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 23, ka përcaktuar se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtën të përmirësojnë aftësitë profesionale për vendin e punës nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, nga donatorë të huaj apo nga të ardhurat vetanake”*, si dhe nenit 15 të këtij ligji, i cili përcakton se: *“1. Çdo institucion, që merr në punë zyrtarë publikë, është i obliguar të përgatisë planin vjetor dhe afatmesëm të personelit, në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor. 2. Planifikimi i personelit bëhet me qëllim që të sigurohet personel adekuat, me njohuri, aftësi dhe cilësi të nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin e vazhdueshëm të institucionit dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë. 3. Planet e personelit hartohen për të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë dhe duhet të përmbajnë: 3.1. një analizë për nevojat e personelit, bazuar në karakteristikat aktuale të stafit dhe prioritetet e institucionit dhe të Qeverisë; 3.2. një analizë e mënyrave për përmbushjen e këtyre nevojave; 3.3. zhvillimin profesional të stafit ekzistues dhe nevojat për trajnim të personelit; 3.4. lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritjen në detyrë; 3.5. krijimin e vendeve të reja, të lira, të punës, si dhe afatet e plotësimit të tyre”*.

Nisur nga përcaktimi ligjor si më lartë, dhe marrë për bazë edhe natyrën e punës së pozitës së ankuesit, Kolegji ka konstatuar se kërkesat e ankuesit për pjesëmarrje në takimet e specifikuara si më sipër, i referohen fushës së përgjegjësi të ankuesit gjegjësisht transparencës së institucioneve komunale, dhe se në vlerësimin e Kolegjit takimet e tilla konsiderohen me rëndësi dhe interes për punën e ankuesit në veçanti dhe për Komunën e Hanit të Elezit në përgjithësi, andaj, mos shqyrtimi i kërkesave në fjalë të ankuesit nga Drejtoresha për Administratë të Përgjithshme, bie në kundërshtim me vet përgjegjësitë e kësaj të fundit, ngase e njëjta në cilësi të udhëheqëses së Drejtoreshës për Administratë të Përgjithshme është përgjegjëse për përcaktimin e objektivave të drejtorisë dhe njësi përbërëse, monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre, ashtu siç përcaktohet me nenin 19 të Ligjit NR.06/L -113 për



Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, rrejdhimisht, Drejtoresha për Administratë të Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit, mbanë përgjegjësi menaxheriale në raport me stafin vartës, duke nënkuptuar se e njëjta, ka për detyrë që të shqyrtoj kërkesat e ankuesit për pjesëmarrje në takime apo trajnime, dhe se e njëjta në varësi të vlerësimit të saj mund të refuzoj apo aprovoj pjesëmarrjen e ankuesit në këto takime/tryeza, duke arsyetuar çdo herë bazën e refuzimit apo aprovimit të pjesëmarrjes. Andaj, mbi këtë konstatim, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Referuar arsyetimit të Drejtoreshës për Administratë të Përgjithshme, se mos trajtimi i kërkesave të ankuesit për pjesëmarrje në takime dhe tryeza, është bërë mbi bazën se ankuesi nuk ka përmbushur detyrat e punës, Kolegji vlerëson së një pretendim i tillë nuk ka mbështetje ligjore përkitazi me objektin e kësaj ankesë, sepse, mos përmbushja e detyrave të punës nga nëpunësi civil duhet të trajtohet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë si dhe përgjegjësinë disiplinore.

Në kuptim të pretendimit të ankuesit për mos miratim të pjesëmarrjes në trajnime, Kolegji i Këshillit, nga vlerësimi i provave materiale të lëndës, ka gjetur se Komuna e Hanit të Elezit ka të miratuar planin e trajnimeve për nëpunësit civil, me numër 02Nr: 1154/2023, për periudhën janar-dhjetor 2023, mirëpo i njëjti plan nuk ka specifikuar audiencën e zyrtarëve që do të ndjekin këto trajnime. Rrejdhimisht, referuar nenit 15 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, institucionet janë të detyruar që në kuadër të planit vjetor të personelit të përfshijnë edhe planin e trajnimeve të stafit në pajtim me nevojat e identifikuar të stafit për trajnime. Andaj, duke qenë së trajnimet të cilave ankuesi i'u referohet në ankesën e parashtruar në Këshill, janë mbajtur në gjysmën e parë të viti 2023, atëherë, sipas Kolegjit, objekti lidhur me këtë pretendim ankimor është bërë i pamundur në kuptim 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.998/2023.

Ardita Përcuku-SHYTI

Ardita Përcuku
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

